Kronikë

Gramsh/ Pas sherrit me fqinjin për prerjen e pemës frutore, i zbulohet arsenal armatimi në banesë! Arrestohet 55-vjeçari (Emri)

Policia finalizon operacionin e koduar "Indicia". Sekuestrohen 1 armë zjarri kallashnikov dhe 690 fishekë të kalibrave të ndryshëm, 53-vjeçari e denoncoi dhe tregoi motivet

Arma dhe municionet e kapura nga policia

Redaksia
19 Gusht, 09:37 | **Përditesimi: 19 Gusht, 09:45**

Share

Gramsh- Sherri mes fqinjëve për pak sa nuk ka përfunduar në krim më të rëndë, por ndërhyrja e Policisë së Gramshit shmangu një ngjarje tragjike të mundshme.

Dhe pas kontrolleve për kapjen e agresorit 55-vjeçar, blutë arritën të zbulonin një arsenal të vogël armatimi, që i dyshuari e mbante në banesë. Një armë automatike "Kallashnikov" pa leje dhe 690 fishekë.

Burime zyrtare thanë se ngjarja ka ndodhur në fshatin Shënmrizë dhe sot (19 Gusht) prangosën gjatë operacionit të koduar "Indicia", 55-vjeçarin Ismet Rama, duke e izoluar në paraburgim.

LEXO EDHE:
Elbasan/ Bleu karburant, me kartëmonedhë 100 euroshe false, arrestohet 35-vjeçari

Policia sqaroi se denoncimi ishte bërë nga fqinji 53-vjeçar i të dyshuarit dhe shkak ka qenë dëmtimi i një peme frutore nga agresori, që edhe e ka kërcënuar.

> *"Gjatë kontrolleve në banesën e 55-vjeçarit, të kryera në kuadër të operacionit policor të koduar "Indicia", u gjetën 1 armë zjarri kallashnikov dhe 690 fishekë të kalibrave të ndryshëm, të cilat posedoheshin pa leje, nga ky shtetas", bëri me dije policia.*

Ndaj të ndaluarit u ngrit akuza "mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe municionit" dhe "prerja e druve dekorative dhe frutore", kurse dosja për hetime të mëtejshme i kaloi prokurorisë vendore.

A.Q/Shqiptarja.com

TAG: arrestim Armatime gramsh Elbasan

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH ZONE

Sondazhi i ditës:
Kredimarrësit e këqinj s'do marrin më kredi, si e vlerësoni rregulloren e BSH?

Të mirë Të keqe Nuk e di

Lajme të tjera

Riten kostot e rrugëve/ Zgjerimi i Tiranë-Durrës 298 mln euro, dyfishohet fatura për Ndroq-Plepa e Baypass-in e Elbasanit! 'Ngec' projekti i Skavicës

Eliza Gjediku

18 Gusht, 19:20

Trafik i rënduar në hyrje të Elbasanit, Policia: Ngadalësim i lëvizjes së mjeteve, jo bllokim! Shtim i patrullave për menaxhimin e situatës

17 Gusht, 16:16

Arrestohet polici i burgut të Peqinit, fuste drogë në qeli! Hetohen bashkëpunëtorët

16 Gusht, 14:58

Vodhi në dy lagje të Durrësit një makinë dhe çantën e një turisti, kapet në Elbasan 29 vjeçari! Ishte në kërkim dhe nga policia e Tiranës për 4 vjedhje (EMRI)

15 Gusht, 15:22

Artan Lame: Arti sublim! Kazerma e Krastës e ndërtuar me 50 milion franga ari, sot e rrafshuar deri në themel

Artan Lame

15 Gusht, 11:50

Dhia u pret rrugën, plagosen dy vëllezërit që po lëvizën me motor në Kanionin e Holtës! Përfundojnë te Trauma

12 Gusht, 19:35

Durrës/ Ktheu lokalin në lagjen e plazhit në pikë për shitje të kokainës te klientët, në pranga pronari dhe badiguardi (Emrat)

12 Gusht, 09:31

Tiranë/ I vuri zjarrin tokës së kushëririt, policia kap në ndjekje 58-vjeçarin e dyshuar! I gjendet dhe çakmaku me të cilin ndezi flakët (Emri)

12 Gusht, 08:48

Elbasan/ Zjarri përfshin dy banesa të braktisura në fshatin Bardhaj, në njërën prej tyre kishte dhe fishekë

11 Gusht, 18:29

Krushku sulmon me breshëri automatiku banesën e vjehrrit të djalit, Policia e Divjakës e arreston! Detajet e para të krimit

10 Gusht, 12:03

Përplasen dy automjete në aksin e vjetër Elbasan-Tiranë, humb jetën shoferi 72-vjeçar

7 Gusht, 14:19

Mashtronte dhe gjobiste pronarët e dyqaneve nëpërmjet telefonit, arrestohet 21-vjeçari në Gramsh! Për të marrë paratë përdorte të miturin (EMRI)

7 Gusht, 10:52

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje